



GAZIDEDË
CUSTOMS & EXCISE CONSULTING

Regjimi i Përpunimit Aktiv dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për operacionet e përpunimit

Besar Gazidede | Konsulent Doganor & Akcize

Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize

Telefon: +355 69 405 0005, Email: besar.gazidede@gazidede.al, Web: <https://www.gazidede.al>

Rruga Sulejman Delvina, Sheshi Wilson, 1/1, Tiranë, Shqipëri

Regjimi i Përpunimit Aktiv dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Regjimi i përpunimit aktiv është një procedurë doganore e cila mundëson përpunimin e mallrave joshqiptare brenda territorit Shqiptar. Detyrimet e importit dhe taksat (përfshirë TVSH) për këto mallra nuk aplikohen për aq kohë sa [mallrat] qëndrojnë në regjim dhe i nënshtrohen operacioneve përpunuese.

Ndonëse detyrimet e importit dhe taksat (përfshirë TVSH) për mallrat në regjim nuk aplikohen sipas parashikimeve të legjislacionit doganor, operacionet e përpunimit mbi mallrat joshqiptare përbëjnë furnizim i shërbimi - shërbimi i përpunimit të mallrave - i cili bie në fushën e zbatimit të TVSH dhe i nënshtrohet tatimit.

Ndryshimi

Me versionin në fuqi të Ligjit për TVSH para datës 1 Janar 2019, shkalla e tatimit me TVSH për furnizimin e shërbimit të përpunimit të mallrave joshqiptare mund të ishte 0% ose 20%, në varësi të rolit të palëve të përfshira në operacionet përpunuese të mallrave të vendosura në regjimin e përpunimit aktiv. Furnizimi i shërbimit të përpunimit nga shoqëria e përpunimit aktiv drejt pritësit të huaj tatohej me TVSH në shkallën 0%. Nga ana tjetër, furnizimi i shërbimit të përpunimit nga nënkontraktorët vendas drejt Shoqërisë së përpunimit aktiv tatohej me TVSH në shkallën 20%. Si pasojë, shoqëritë e përpunimit aktiv të cilat nënkontraktin shërbimet e përpunimit brenda vendit (pjesërisht ose tërësisht) në periudhë shumë të shkurtër akumulonin tepër kredi të TVSH, gjë e cila ndikonte drejtpërdrejt në likuiditetin e shoqërive të përpunimit aktiv.

Me hyrjen në fuqi të [Ligjit nr. 96/2018 datë 3.12.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 92/2014, Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"](#) u specifikua se furnizimi i shërbimit të përpunimit të mallrave joshqiptare nga nënkontraktorët drejt shoqërisë së përpunimit aktiv i nënshtrohet tatimit me TVSH në shkallën 0%, duke adresuar një problematikë disa vjeçare dhe lehtësuar shoqëritë e regjimit të përpunimit aktiv që nënkontraktajnë shërbimet e përpunimit brenda vendit (pjesërisht ose tërësisht).

Kushtet

Kushtet specifike për përfshirjen e nënkontraktorëve në operacionet e përpunimit të mallrave joshqiptare si dhe për aplikimin e shkallës tatimore të TVSH prej 0% për shërbimin e përpunimit furnizuar nga nënkontraktorët drejt shoqërisë së përpunimit aktiv, përshkruhen në Nenin 48 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 6 datë 30.01.2015 "Për TVSH", i cili në mënyrë të përmbledhur parashikon se:

1. Nënkontraktori duhet të jetë i identifikuar në Autorizimin e Regjimit të Përpunimit Aktiv të shoqërisë së përpunimit aktiv lëshuar nga autoritetet doganore;
2. Nënkontraktori duhet të jetë i autorizuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore për përfshirjen në operacione të përpunimit aktiv;
3. Nënkontraktori duhet të mbajë një regjistër të veçantë lidhur me lëvizjen e mallrave dhe operacionet e përpunimit që kryen;

4. Lëvizja e mallrave nga shoqëria e përpunimit aktiv drejt nënkontraktorit duhet të dokumentohet me faturë shoqërimi;
5. Lëvizja e mallrave nga nënkontraktori drejt shoqërisë së përpunimit aktiv duhet të dokumentohet me faturë tatimore me TVSH në shkallën 0%.

Rekomandim

Rekomandojmë që shoqëritë të cilat ushtrojnë aktivitet duke përdorur regjimin e përpunimit aktiv të sigurohen se nënkontraktorët e tyre përbushin kushtet e kërkuara, pasi në disa raste specifike mos-përbushja e detyrimeve nga nënkontraktorët mund të impaktojë edhe vetë shoqërinë e përpunimit aktiv.

Ky material është i natyrës së përgjithshme me karakter informues dhe nuk ka si qëllim adresimin e çështjeve specifike.

Ky material nuk përbën këshillë specifike profesionale.

Ne nuk mbajmë asgjë përgjegjësi lidhur me veprimet që ju apo palë të tjera ndërmerrni duke u bazuar mbi këtë material, pa marrë këshillë specifike profesionale.

© Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Rreth Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize

Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize është emri tregtar i subjektit Besar Gazidede - Person Fizik, regjistruar me datë 1 Nëntor 2018 në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L82301001A, me adresë Rruga Sulejman Delvina, Sheshi Wilson, 1/1, Tiranë, Shqipëri..

Ne ofrojmë ekspertizë, këshillim dhe asistencë ligjore, procedurale dhe praktike:

- në fushën doganore;
- në fushën e akcizës në import dhe prodhimin vendas;
- në fusha të tjera që lidhen me lëvizjen ndërkombëtare të mallrave si TVSH, Taksat Kombëtare etj.

Shërbimet tona janë të dedikuara për importuesit, eksportuesit, prodhuesit, tregtarët, postën e shpejtë, transportuesit, agjensitë doganore, individët etj.

Ne reduktojmë kompleksitetin e legjislacionit dhe e vendosim atë në shërbim të interesit më të mirë të Klientëve tanë, me qëllim realizimin e objektivave si optimizimi i detyrimeve dhe taksave të pagueshme; optimizimi logjistik; kryerja e formaliteteve në mënyrë eficiente, pa pengesa dhe në kohë sa më të shkurtër

Rreth Besar Gazidede



Besar Gazidede është ekspert doganor dhe akcize me eksperiencë të gjerë pranë sektorit publik dhe privat. Është themelues i Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize me seli në Tiranë, Shqipëri ku ofron ekspertizë, këshillim dhe asistencë për kompanitë e përfshira në tregtinë ndërkombëtare të mallrave.

Eksperiencat e mëparshme të punës përfshijnë PricewaterhouseCoopers Albania and Kosovo si Konsulent Doganor & Akcize (2015-2018), Go Shipping Albania si Specialist për Import & Eksport (2014-2015), Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave si Specialist i Analizës së Riskut dhe Përgjegjës Sektori (2010-2014).

Besari është Diplomuar pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Dega Ekonomiks (2006-2010).

Keni nevojë të diskutoni me një ekspert lidhur me veprimtarinë doganore & akcizës të biznesit tuaj?

Jemi në dispozicion për t'ju asistuar.

Besar Gazidede | Konsulent Doganor & Akcize
Gazidede Konsulencë Doganore & Akcize
+355 69 405 0005
besar.gazidede@gazidede.al